



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Kabineti i Ministrit/ Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

Numër: 01/2688
Datë: 18-06-2026

Ministria e Arsimit dhe Shkencës në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G.Z. e Republikës së Kosovës/Nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë) dhe udhëzimin administrativ 136/2020, për krijimin e strukturës stimuluese për mbështetjen e shkollimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe për vajzat/gratë në Drejtimet teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), nxjerr:

V E N D I M

Për ndarje të bursave për nxënës në drejtimet deficitare dhe për vajza në drejtimet teknike në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin e ri shkollor 2026-2027 shpallë konkursin për ndarjen e bursave për nxënësit e Institucionave të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për klasën e 10-të.
2. Vlera e bursës për nxënës është 50 (pesëdhjetë) euro në muaj (përveç muajt korrik dhe gusht), përkatësisht 500 (pesëqind) euro për një vit shkollor.
3. Numri i bursave në total është 100, për drejtimet deficitare 70 dhe për vajza në drejtimet teknike është 30.
4. Në drejtimet deficitare mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e IAAP-ve ndërsa, për drejtimet teknike vetëm vajzat.
5. Bursat ndahen për tri vite të shkollimit në AAP siç është përcaktuar me UA.

6. Bursa për drejtimet deficitare:

- 6.1. Teknik i sistemeve solare fotovoltaike;
- 6.2. Pylltari;
- 6.3. Agrobiznes;
- 6.4. Asistent i turizmit dhe udhëtimeve;
- 6.5. Përpunimi i drurit/Zdrukthëtar;
- 6.6. Metalpunues

7. Bursat për vajza dhe gratë në drejtimet teknike:

- 7.1. Instaluese elektrike;
- 7.2. Instaluese e ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit;
- 7.3. Automekanike;
- 7.4. Teknike e efijencës së energjisë në ndërtesa
- 7.5. Teknike e dizajnit grafik

8. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë, si dhe me qëllim të përkrahjes së Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP), duke pas parasysh nevojat e tregut të punës, si dhe në mbështetje të kërkesave të IAAP-ve dhe stimulimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe vajzave në drejtimet teknike, u vendos si në dispozitat e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA-ve);
4. Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP);
5. Departamentit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional
6. Departamentit të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
7. Arkivit të MASHTI

Hajrulla Çeku
Ministër në detyrë i
Arsimit dhe Shkencës

